



SYLLABUS I LËNDËS: “ESEISTIKË”

Të dhëna bazike të lëndës:	
Universiteti:	Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Eseistikë
Programi:	Gjuhë dhe letërsi shqipe
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore (Z)
Viti i studimeve:	Viti III, Semestri V
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Manjola Brahaj Halili
Të dhënat kontaktuese:	manjola.brahaj@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Duke qenë se Eseistika është disiplina shkencore mbi esenë, strukturën e esesë, llojet, problemet teorike e metodologjike të saj, programi i kësaj lënde përmban trajtimin e procesit krijues të esesë si një lloj letrar më vete, me teknikat, strukturën, tematikat dhe detajet ndërtimore të saj. Programi do përqëndrohet gjithashtu edhe në teknikat shkrimore, drejtshkrimore e strukturore të eseve. Do të trajtojë të gjitha llojet e eseve dhe klasifikimet e tyre, por theksi do vihet më shumë tek esetë letrare dhe herë pas here këto lloje do të konkretizohen me shembuj nga esetë e eseistëve të shquar shqiptar dhe të huaj. Në këtë mënyrë studentët do të kenë një panoramë më të qartë të lindjes, zhvillimit dhe rëndësisë që ka eseistika në zhvillimin e mendimit dhe kulturës në përgjithësi.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me veçantinë e esesë si lloj i shkrimit, me modelet më të sukseshme të shkrimit të esesë, me mjetet shprehëse, me karakterin e saj dual letërsi-shkencë etj.</p> <p>Pastaj të mësojnë të shkruajnë esenë, të njohin modelet e shkrimit të esesë në gjuhën shqipe etj.</p>
Rezultatet e të nxënit:	<p>Gjatë dhe pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin esenë si lloj i veçantë i shkrimit që inkorporon aspektin letrar dhe atë ditoror;• përshkruajnë rrugën zhvillimore të esesë dhe të eseistikës përgjithësisht;• dallojnë esetë nga njëra – tjetra dhe t'i klasifikojnë ato sipas tematikës dhe qëllimit;• shkruajnë lloje të ndryshme esesh• analizojnë dhe vlerësojnë një ese duke u bazuar tek



	teknikat ndërtimore, shkrimore dhe struktura.		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	13	13
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	5	5
Totali			100 orë (4 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjëratat do të organizohen në modelin interaktiv ose të kombinuar si: shpjegim - sqarim, ushtrime, analiza tekstuale dhe shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, prezantime dhe rishikime ide, dizajne kreative dhe vetë-kërkuese, etj. pjesa kryesore për punën vlerësuese dhe mënyrën apo metodologjinë e pedagogut.		
Metodologjia e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve bazohet në punën, aktivizimin, frekuentimin, kolektivumet dhe punimin e prezantuar në përmbyllje të semestrit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Testi i parë: 1 – 35 % 2. Testi i dytë: 1 – 35 % 3. Prezantimet studentore – 10 %, 4. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1-20 % 5. Totali: 100 % <p>(Vlerësimi në pikë: 01-50= 5, 51-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10</p>		
Literatura			
Literatura primare:	Gjovalin Shkurtaj: Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2017. Si të shkruajmë ese: (Përgatiti Bardhyl Musai), QAD, Tiranë, 2004. Kathleen McMillan & Jonathan Weyers, Si të shkruajmë		

	ese dhe detyra, Tiranë, 2010 (perkthim nga Xhevat Lloshi)
Literatura shtesë:	Nasho Jorgaqi: Antologji e mendimit estetik shqiptar, Dituria, Tiranë 2000. Ernest Koloqi: Ese të letërsisë shqipe, (përkth. Dhurata Shehri), IDK, Tiranë 2010. Italo Calvino: Leksione amerikane, (përkth. Renata Martini) Shtëpia e librit, Tiranë 2000. Univers në një rrokje: (përkth. Luan Canaj) Onufri, Tiranë 2022.

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<i>Hyrje në eseistikë. Origjina dhe zhvillimi i eseistikës.</i>	<i>Njohja e autorëve të parë shqiptar dhe botëror. Diskutime.</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>Procesi i të shkruarit. Parapërgatitja.</i>	<i>Realizimi i një teksti eseistik pas një parapërgatitjeje.</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>Klasifikimi i eseve: llojet e eseve për nga tematikës dhe fushës.</i>	<i>Lexime esesh të temave të ndryshme. Diskutime.</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>Klasifikimi i eseve: llojet e eseve për nga përmbajtja dhe qëllimi</i>	<i>Lexime dhe komentime esesh; rrefyese, përshkruese, shpjeguese, argumentuese etj.</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>Eseja hulumtuese. Hulumtimi i materialit. Leximi, kërkimi, mbajtja e shënimeve.</i>	<i>Detyra me shkrim – fillimi i punës për një ese.</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>Strategjitë e leximit. Metoda dhe shembuj</i>	<i>Lexime konkrete me objektiv mbledhjen e informacioneve për shkrimin e esesë.</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<i>Shkrimi i kopjes së parë të esesë. Struktura bazë; (Hyrja, Trungu, Mbyllja.</i>	<i>Detyrë shkrimi i një eseje)tema e lirë).</i>
<i>Java e tetë:</i>	<i>Testi i parë vlerësues</i>	<i>Përmbledhje e lëndës.</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>Teknika e të shkruarit. Stili i shkrimit universitar. Forma e tekstit – paragrafët dhe rëndësia e organizimit.</i>	<i>Paragrafët e esesë. Shembuj</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit dhe përdorimi i shenjave të pikësimit.</i>	<i>Lexime ose shkrime tekstesh për të parë zbatimin e shenjave të pikësimit në shkrimin e esesë.</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Rishikimi, redaktimi dhe korrigjimi i eseve.</i>	<i>Redaktimi i tekstit të një eseje – rishikimi i esesë.</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Struktura, citimi dhe renditja e referencave në esenë</i>	<i>Diskutime për rëndësinë e referencave në esenë argumentuese.</i>



	<i>argumentuese.</i>	<i>Shembuj dhe konkretizime.</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>Shkrimi i eseve pa parapërgatitje. Esetë e lira, esetë në provime (Shembuj nga eseistët e huaj).</i>	<i>Lexime esesh të lira, kulturore apo artistike. Diskutime të lira.</i>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<i>Esetë letrare dhe vlerësuese. Karakteristikat, qëllimi dhe përdorimi. (Shembuj nga eseistët të huaj dhe shqiptar).</i>	<i>Lexime nga ese letrare dhe vlerësuese dhe diskutime rreth realizimit e qëllimit të tyre.</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Testi i dytë vlerësues</i>	<i>Diskutime dhe konsultime rreth rezultateve të arritura</i>
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<p>Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.</p> <ul style="list-style-type: none">• Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor.• Pritet që secili student të vijë me kohë.• Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjeratë.• Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimin në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë.		